



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 07.02.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 06.02.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Nica construction" për aktivitetin: "**Tregu i ri i qytetit**" dhe me numër të prokurimit: **616 19 029 511** nxjerr:

V E N D I M

Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "Niva construction" e datës 06.02.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Tregu i ri i qytetit" dhe me numër të prokurimit: **616 19 029 511** kundër *Njoftimit për kontrate të AK-se te datës 30.12.2019*, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.

1. Vërtetohet *Njoftimi për kontrate i Autoritetit Kontraktues të datës 130.01.2020*;
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik " Niva construction" me datë 06.02.2020 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: 'Tregu i ri i qytetit' dhe me numër të prokurimit: **616 19 029 511**.

Autoriteti Kontraktues e konsideron si të jashtë afatshme parashtrimin e Kërkeses epr rishqyrtim dhe nuk e merr parasysh ta shqyrtoj.

Kërkesa për rishqyrtim konsiderohet e jashtë afatshme konform ligjit të prokurimit publik perkatesisht Formularit *FO3 Rregullat për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave, mbeshtetur në dy nene:*

Neni 4

Periudha kohore për dorëzimin e një kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteti Kontraktues

Kërkesa për rishqyrtim duhet të paraqitet me shkrim dhe duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues, me postë ose me çdo mjet tjetër të komunikimit të lejuar me këtë ligj, brenda afateve të mëposhtme:

- a) Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë **(5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave.**

Neni 7

Refuzimi i një kërkesë për shqyrtim

7.1 Autoriteti Kontraktues, **respektivisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit**, do ta refuzojë një kërkesë për rishqyrtim kur:

- a) kërkesa nuk dorëzohet brenda afateve kohore të përcaktuara në nenin 4 të këtyre rregullave .
Ne përputhje me nenin 7.1 (a) të këtyre rregullave:
 - ii. kurdo që refuzimi i kërkesës ndërlidhet me **njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit**, Autoriteti Kontraktues vazhdon me tutje me procedurën e prokurimit.

Duke e ditur se data e hapjes është me 10.02.2020 Parashtrimi i kërkesës për rishqyrtim është bërë 4 ditë para hapjes, dhe jo të pakten 5 ditë siç kërkohej në rregulloren.

Bazuar në konstatimet paraprake u vendos si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Shtojcë: Deklarata e tenderuesit për Aneksin 1.

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

